



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 shkurt 2021
Nr. ref.:RK 1717/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI30/20 dhe KI31/20

Parashtrues

Sibin Ristić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve
të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë
Kosovare të Pronës: Aktgjykimi GSK-KPA-A-239/2015, i 20 tetorit 2018,
dhe Aktgjykimi GSK-KPA-A-238/2015, i 15 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë parashtruar nga Sibin Ristić nga Podujeva, me vendbanim në Kragujevc, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), dhe atë: Aktgjykimit GSK-KPA-A-239/2015, të 20 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit GSK-KPA-A-238/2015 të 15 nëntorit 2018.
3. Të dy aktgjykimet e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 tetor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të cilat Gjykata i regjistroi me numër KI30/20 dhe KI31/20.
7. Më 19 shkurt 2020, me Vendimin e Kryetares së Gjykatës, e në pajtim me nenin 40.1 të Rregullores së punës për bashkimin e kërkesave, kërkesa KI31/20 është bashkuar me kërkesën KI30/20. Rrjedhimisht, kërkesat shqyrtohen në Gjykatë si një lëndë e bashkuar.
8. Më 19 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 2 mars 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe njëkohësisht kërkoi nga ajo që të dorëzojë dëshmi se kur i janë dorëzuar parashtruesit të kërkesës aktgjykimet të cilat kontestohen nga ai.

11. Më 3 mars 2020, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën për dorëzimin e aktgjykimit GSK-KPA-A-238/2015 dhe aktgjykimit GSK-KPA-A-239/2015.
12. Më 3 shkurt 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Fillimisht, Gjykata vëren se kërkesat në fjalë kanë të bëjë me juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), për t'u marrë me çështjen e kthimit në riposedim të dy ngastrave për të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se ka të drejtë pronësie mbi to. Gjykata gjithashtu vëren faktin se parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë Kushtetuese vetëm në emrin e tij, edhe pse kërkesat për kthim në riposedim të ngastrave në fjalë ishin parashtruar në institucionin e AKP-së bashkërisht nga disa bashkëpronarë potencialë, midis të cilëve ishte edhe parashtruesi i kërkesës. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata në vazhdim do t'i shqyrtojë faktet vetëm në lidhje me parashtruesin e kërkesës.
14. Më 12 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës, si një nga bashkëpronarët, mori pjesë në paraqitjen e kërkesave në AKP, në të cilat kërkoi pjesë në riposedimin e dy ngastrave kadastrale që gjinden në Surkish, Komuna e Podujevës, përkatësisht ngastrën kadastrale 318, me sipërfaqe prej 0.34,11 ari, si dhe në ngastrën kadastrale 315/2, me sipërfaqe prej 03.74 ari.
15. Në kërkesën e tij për riposedimin e pronës, parashtruesi i kërkesës theksoi se *"humbja e pronësisë mbi pronën e kontestuar ka ndodhur si pasojë e rrethanave të cilat kanë mbizotëruar gjatë periudhës 1998/1999 në Kosovë dhe se ai të drejtën e posedimit e ka humbur më 12 qershor 1999, kur prona lëndore është uzurpuar, dhe për këtë kërkon kthimin e pronës në posedim dhe kompensim për shfrytëzim të paligjshëm"*.
16. Gjykata gjen se kërkesat për riposedim të ngastrave kadastrale 315/2 dhe 318, të parashtruesit të kërkesës, janë regjistruar nga AKP-ja me shenja të ndryshme. Kërkesën për riposedim të ngastrës kadastrale 315/2, me sipërfaqe prej 03.74 ari, AKP-ja e regjistroi me shenjën KPA40042, ndërsa kërkesën për riposedim të ngastrës kadastrale 318, me sipërfaqe prej 0.34.11 ari, AKP-ja e regjistroi me shenjën KPA40043.
17. Më 31 mars 2008, edhe personi U.J. parashtroi kërkesë në AKP, duke pretenduar se ai kishte të drejtë ligjore mbi pronën në fjalë sepse e kishte marrë me qira në vitin 1995 nga ndërmarrja shoqërore "Drita".

Procedura në AKP në lidhje me kërkesat KPA40042 dhe KPA40043

18. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së, me qëllim të verifikimit dhe vërtetimit të të dhënave nga kërkesat e parashtruesit, sipas detyrës zyrtare, në Shërbimin Kadastral në Podujevë gjeti fletën poseduese nr. 81, të 5 majit 2008, në të cilën pronat në fjalë, përkatësisht ngastra kadastrale nr. 318 me sipërfaqe prej 0.34,11

ari dhe ngastra kadastrale nr. 315 me sipërfaqe prej 03.74 ari, ishin të regjistruara si pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Drita".

19. Parashtruesi i kërkesës gjatë një bisede të mëpastajme me Sekretariatën Ekzekutiv të AKP-së deklaroi se prona në fjalë i ishte kthyer në vitin 1993 dhe *"që nuk ka ditur se kush e ka shfrytëzuar të njëjtën gjatë periudhës 1996/1999, por supozon se ajo edhe më tutje është shfrytëzuar nga ndërmarrja shoqërore"*.
20. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së, duke pasur parasysh gjetjet e tij sipas të cilave prona në fjalë është nën juridiksionin e Ndërmarrjes Shoqërore "Drita", e njoftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit për kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
21. Agjencia Kosovare e Privatizimit, në përgjigjen e saj, njoftoi Sekretariatën Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës se Agjencia Kosovare e Pronës nuk ka juridiksion mbi pronat (ngastrat) në fjalë sepse ato janë pronë shoqërore, ndërsa prona shoqërore bie në juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjithashtu, sqaroi se *"NSH "Drita" ka menaxhuar me pronën lëndore në periudhën deri në vitin 1999, e pastaj prej vitit 1999 deri në vitin 2013, prona është menaxhuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, se në vitin 2013, ndërmarrja shoqërore "Drita" ka hyrë në proces të likuidimit dhe rrjedhimisht është dashur që të ishin ndërprerë të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore lidhur me pretendimet ndaj kësaj ndërmarrje, pasi që vetëm organi i likuidimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është kompetent të shqyrtojë të gjitha kërkesat lidhur me këtë ndërmarrje shoqërore."*
22. Më 27 korrik 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), si organ i shkallës së parë i cili është kompetent për zgjidhjen e kërkesave të AKP-së, nxori Vendimin Grupor KPC/D/C/256/2014, i cili përfshinte të dy kërkesat e parashtruesit. Në Vendimin KPC/D/C/256/2014, KKPK-ja e shpalli veten jokompetente për këto kërkesa, duke theksuar se *"prona lëndore i ka takuar ndërmarrjes shoqërore dhe është vënë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (e pastaj nën pasuesen e saj, Agjencinë Kosovare të Privatizimit) në bazë të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar me Urdhëresën e UNMIK-ut 2005/18."*
23. Përveç kësaj, sa i përket kompetencës lëndore për këto kërkesa, KKPK-ja theksoi se Ndërmarrja Shoqërore është në procedurën e likuidimit, prandaj *"prona në fjalë bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës [për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit] në pajtim me nenin 4.1 (c) dhe nenin 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 për Dhomën e Posaçme [...] Në këto rrethana, KKPK konkludoi se "mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore nuk e humbi kontrollin mbi pronën në fjalë si rezultat i konfliktit të vitit 1998/1999, por si rezultat i procedurës pasuese të privatizimit. Sipas kësaj, kërkesa bie jashtë kompetencës së komisionit"*.

24. Në të njëjtin Vendim, KKPK-ja gjithashtu theksoi se me Vendimin KPC/D/C/256/2014, nuk e paragjykoj të drejtën e asnjë pale dhe se *“palët mund të kërkojnë mjetin juridik para gjykatës kompetente”*.
25. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme, ndaj Vendimit Grupor KPC/D/C/256/2014 të KKPK-së. Në këtë ankesë, ai pretendoi se të drejtë në pronësi në pronën në fjalë në bazë të Vendimit të Komisionit për kthim të tokave të KK Podujevë 04.Nr. 461-22/93, të datës 30 majit 1993 dhe se ai kishte humbur posedimin e pronës në fjalë për shkak të rrethanave të vitit 1998/1999.

Procedura në Gjykatën Supreme

26. Sa i përket procedurës në Gjykatën Supreme, Gjykata vëren se ajo në procedurën sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës i analizoi ndaras pretendimet ankimore në lidhje me kërkesat KPA40042 dhe KPA40043, dhe rrjedhimisht, si rezultat i këtyre rrethanave procedurale, nxori dy aktgjykime të veçanta.
27. Në këtë drejtim, sa i përket kërkesës KPA40042, Gjykata Supreme, më 20 tetor 2018, nxori Aktgjykimin me shenjën GSK-KPA-A-238/2015.
28. Ndërsa sa i përket kërkesës KPA40043, Gjykata Supreme AKP, më 15 nëntor 2018, nxori Aktgjykimin me shenjën GSK-KPA-A-239/2015.
29. Duke analizuar të dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme, Gjykata vërejtë se arsyetimet dhe qëndrimet juridike të Gjykatës Supreme, në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruesit, janë identike. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i paraqesë ato së bashku, gjegjësisht si një arsyetim juridik të Gjykatës Supreme.
30. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në arsyetimet e të dy aktgjykimeve, trajtoi dy pretendime kryesore ankimore të parashtruesit të kërkesës. Pretendimi i parë ankimor i parashtruesit lidhet me mënyrën e fitimit të pronës në pajtim me dispozitat ligjore që ishin në fuqi në vitin 1993, ndërsa pretendimi i dytë ankimor lidhet me juridiksionin e AKP-së në procedurën në fjalë, për të vendosur për kërkesat lëndore, gjegjësisht kërkesën e tij.
31. Sa i përket pretendimit të parë ankimor, Gjykata Supreme në të dyja aktgjykimet konstatoi se: *“Në përputhje me nenin 20 të Ligjit për të drejtat themelore pronësore-juridike (Fletorja zyrtare nr. 6/1980) në fuqi në kohën kur është lëshuar Aktvendimi i Komunës së Podujevës – Komisioni për udhëheqjen e procedurës për kthimin e tokës, 04 nr. 461-22/93 të datës 30.05.1993, me të cilin është kthyer në pronësi dhe posedim të pronës [...] e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të punës juridik, (transferimit juridik) dhe me trashëgimi.*

Megjithatë, me nenin 33 të Ligjit për të drejtat themelore pronësore-juridike (GZ e RSFJ-së, nr. 6/80), është përcaktuar që në bazë të procesit gjyqësor, të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme e fiton me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Madje edhe ligji i

tashëm nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36, par. 1, parashikon që “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri, ...nga kjo mund të përfundohet se Aktvendimi mbi kthimin e pronës nuk është zbatuar në mënyrën e paraparë me ligj”.

32. Sa i përket juridiksionit të AKP-së për procedurën në fjalë, Gjykata Supreme në arsyetimet e të dy aktgjykimeve konkludoi se: *“Prona lëndore ka qenë e regjistruar mbi ndërmarrjen shoqërore, që do të thotë se ajo ka qenë dhe është pronë e ndërmarrjes shoqërore. Dokumentet të cilat i ka gjetur Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së në Kadastrën në Podujevë vërtetojnë se prona lëndore trajtohet edhe më tutje si pronë shoqërore dhe si e tillë i është nënshtruar procesit të privatizimit, prandaj ajo është në kompetencën ekskluzive të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 4.1 (c) dhe 5.1 (a) të Urdhëresës së UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme e ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.*

Sipas ligjit në fuqi, mbrojtja e të drejtave pronësore mbi pronën shoqërore nuk është në kompetencë të KKKP-së, dhe rrjedhimisht as të Gjykatës Supreme AKP”.

33. Gjykata Supreme, në përfundimin e të dy aktgjykimeve, theksoi se *“këto aktgjykime nuk e vejnë në pikëpyetje çfarëdo të drejte pronësore të pronarit të tashëm e as nuk paraqesin pengesë që palët të iniciojnë procedurë pranë organit kompetent ose gjykatës kompetente nëse këtë e konsiderojnë interes juridik”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e Gjykatës Supreme shkelin të drejtat e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Në aktgjykimet GSK-KPA-A-238/2015 të datës 20.10.2018 dhe GSK-KPA-A-239/2015 të datës 15. 11.2018, Gjykata Supreme , drejtë ka konstatuar që për fitimin e të drejtave pronësore në patundshmëri është e domosdoshme që të plotësohen dy kushte dhe atë: baza juridike e fitimit të pronësisë dhe regjistrimi në librat publike. Megjithatë, në procedimin e mëtejshëm, gjykata gabimisht vjen në përfundim që nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të dy kushtet në çështjen konkrete juridike. Në të vërtetë, është përmbushur kushti i fitimit të drejtës pronësore sipas nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore të RSFJ-së (Fl. Zyrtare nr. 6/1980). Sipas kësaj dispozite ligjore, e drejta pronësore fitohet në bazë të punës juridike, me vendim të organit kompetent shtetëror si dhe në bazë të ligjit. Ankuesi sikurse edhe bashkëpronarët tjerë, të drejtën pronësore e kanë fituar në bazë të Aktvendimit të plotfuqishëm të Komisionit për zbatimin e procedurës dhe lëshimit të aktvendimit sipas kërkesave për kthimin e tokës 04 nr. 461- 22/93 të datës 30.5.1993”.*

35. Gjithashtu, sipas pretendimeve të parashtruesit, *“është përmbushur edhe kushti i detyrës për përfitimin e të drejtës pronësore, dmth. regjistrimit në librat publikë [...] është bërë regjistrimi në regjistrin e shërbimit kadastral në bazë të [...] dokumentit gjyqësor të Gjykatës Komunale në Kurshumli, dega në Podujevë numër II nr. 12/95...”*.
36. Prandaj, parashtruesi i kërkesës thekson që me rastin e vendosjes për të drejtat e tij, nuk ishte vendosur në përputhje me rregulloret që ishin në fuqi në kohën kur ishte fituar e drejta e pronësisë mbi pronën e paluajtshme në fjalë. Konkretisht, Gjykata Supreme e Kosovës nuk e zbatoi në mënyrë të barabartë Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike të RSFJ-së, në lidhje me Vendimin e Entit të Gjeodezisë së Republikës - Shërbimi i Kadastrës së Patundshmërive Podujevë nr. 952-02-2-55 / 96 i 15 majit 1996.
37. Parashtruesi, më tej, pretendon se atij i është shkelur edhe neni 46 i Kushtetutës, si dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, me të cilin garantohet e drejta e pronës dhe se askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e ankimuar është privuar nga prona të cilën e kishte fituar në mënyrë ligjore dhe se, krahas kësaj, nuk ekziston bazë për marrjen e pronës në interesin publik.
38. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i mundësojë atij kthimin e të drejtave pronësore mbi pronën në fjalë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

41. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

“[...]”

2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

42. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysht rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

[...]

(b) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

43. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar mjetet juridike siç kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
44. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i detyron personat që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
45. Duke pasur parasysh shkresat e lëndës, kronologjinë e veprimeve procedurale të ndërmarra të parashtruesit të kërkesës, si dhe vendimet e autoriteteve kompetente, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron që KKPK-ja dhe Gjykata Supreme ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6 dhe 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse ato nuk kanë vendosur në mënyrë meritore në lidhje me kërkesën për kthim të posedimit të pronës në fjalë, për të cilën ai konsideron se kishte të drejta.
46. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, në vitin 2007, si një nga bashkëpronarët potencial, mori pjesë në paraqitjen e dy kërkesave pronësore në AKP, duke konsideruar se pikërisht AKP-ja është institucion i cili është kompetent për t'u marrë me kërkesat në fjalë.
47. Parashtruesi i kërkesës konsideroi se ai më 30 maj 1993 kishte fituar të drejtat pronësore mbi pronën në fjalë dhe se kishte humbur posedimin e kësaj prone si rezultat i ngjarjeve të vitit 1998/1999. Si rrjedhojë, kërkesat për kthimin e pronës në fjalë ai i kishte paraqitur pranë institucionit të AKP-së (Agjencisë Kosovare të Pronës), e cili ka juridiksionin ligjor për zgjidhjen e kërkesave pronësore që lidhen me ngjarjet e vitit 1998/1999, në pajtim me rregulloret ligjore në fuqi (përkatësisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 të 4 marsit 2006).
48. Lidhur me këtë, Gjykata vë në pah se, fillimisht, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së, gjatë procedurës së verifikimit të pronës, konkludoi se prona në fjalë evidentohet mbi ndërmarrjen shoqërore “Drita”. Për këtë arsye nuk është në juridiksionin e AKP-së që të vendosë për çështjen e kthimit të të drejtave pronësore mbi ngastrat kadastrale, por se kjo është ekskluzivisht në juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si dhe të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
49. Gjykata gjithashtu vëren se KKPK-ja, si organ i shkallës së parë i AKP-së, konstatoi se nuk ka juridiksion që të merret me kërkesat në fjalë. Kjo për arsye se parashtruesi nuk e kishte humbur pronën në fjalë si pasojë e rrethanave të vitit 1998/1999, siç parashikohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10, por se prona në fjalë ishte në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore “Drita” dhe se ajo pas vitit 1999 kaloi nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe më

vonë, me miratimin e Ligjit të ri nr. 04/L-034, nën administrimin e pasardhëses së saj, Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

50. Në dritën e kësaj, Gjykata rikujton se çështja e juridiksionit të AKP-së dhe KKPK-së është rregulluar qartë me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, i cili përcakton si në vijim:

"Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50

Neni 3 Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës

3.1 Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

3.2 Asgjë në këtë nen nuk i cenon të drejtat e paditësve që të ndjekin pranë gjykatave kompetente kërkesat që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në nenin 3.1".

51. Duke u mbështetur në këtë kornizë normative, Gjykata vjen në përfundim se KKPK-ja, si organ kompetent i shkallës së parë i AKP-së, nuk ka vendosur asnjëherë mbi kërkesat, përkatësisht për të drejtën e parashtresit për kthimin e pronës në fjalë në riposëdim, për shkak se konstatoi se kërkesa në fjalë nuk bie në fushëveprimin e nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, duke qenë se kemi të bëjmë me pronën e paluajtshme e cila është regjistruar në emër të ndërmarrjes shoqërore dhe, kështu, edhe në juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, përkatësisht të pasardhëses së saj, Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
52. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të theksoj se neni 5.1 a i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, i ndryshuar dhe plotësuar me rregulloret e UNMIK-ut 2005/18 dhe 2008/16, përcakton se:

"Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18

Neni 5 Ndërmarrjet nën administrimin e Agjencisë

- 1. Agjencia është e autorizuar që t'i administrojë*

i) *ndërmarrjet në pronësi publike dheshoqërore të regjistruara në Kosovë deri më 31 dhjetor 1998 apo ndonjë datë pasuese (pavarësisht a i është nënshtruar ndërmarrja transformimit apo jo),*
 ii) *të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës (pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo), të cilat përfshijnë pronën në pronësi shoqërore deri më 22 mars 1989 apo ndonjë datë pasuese.*
 [...]”

53. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se Vendimi i KKPK-së, KPC/D/C/256/2014, nuk trajtoi kërkesat pronësore të parashtruesit për kthim të pronës në posedim, por çështjen e kompetencës së organit përkatëse publik për të vendosur lidhur me një kërkesë të tillë.
54. Për më tepër, Gjykata konstaton se pikërisht KKPK-ja, në vendimin e tij, i dha parashtruesit të kërkesës këshillë juridike, duke e drejtuar në institucionin kompetent i cili ka kompetencë ligjore që të merret me kërkesën e tij pronësore. Përveç kësaj, KKPK-ja sqaroi se me vendimin e tij *“nuk paragjykon të drejtën [e parashtruesit të kërkesës] dhe se parashtruesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjetin juridik para gjykatës kompetente”*.
55. Më tej, në lidhje me shkeljet e pretenduara në procedurën para Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij i ndërlidh ato me ligjshmërinë e përfundimeve të Gjykatës Supreme për çështjen e përmbushjes së kushteve kumulative që mundësojnë fitimin e të drejtave pronësore. Më konkretisht, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme konkludoi gabimisht se ai nuk i ka përmbushur kushtet kumulative në pajtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike të RSFJ-së dhe se, si rrjedhojë, ai nuk mund të ishte pronar i pronës në fjalë deri në vitin 1999.
56. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos vërejë faktin se Gjykata Supreme mori në shqyrtim pikërisht pretendimin e përmendur të parashtruesit dhe se vetëm pas analizimit të dispozitave ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike të RSFJ-së, gjendjes faktike dhe pretendimeve ankimore, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i përmbushi të gjitha kushtet kumulative, mbi bazën e të cilave mund të fitohen të drejtat pronësore.
57. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme arsyetoi se parashtruesi i kërkesës, përkundër Aktvendimit nr. 461-22/93 të vitit 1993, nuk e fitoi të drejtën e pronësisë në pajtim me nenin 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike (GZ e RSFJ nr. 6/80), i cili parashikonte se e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librat publik, ose në ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme sqaroi se *“ligji i aplikueshëm parashikonte veprime të caktuara juridike të cilat duhet të ndërmerren nga pronari i mundshëm për të regjistruar pronën, ndër të cilat ka qenë edhe veprimi i regjistrimit në kadastrën e paluajtshmërive, gjë që parashtruesi i kërkesës nuk e bëri”*. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vuri në dukje se nga fleta poseduese nr. 81, e siguruar nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së, më 5 maj 2008, mund të konkludohet qartë se prona në fjalë evidentohet si pronë shoqërore.

58. Prandaj, Gjkata vë theksin në arsyetimin e Gjykatës Supreme se parashtruesi nuk ka mundur t'i fitonte të drejtat pronësore mbi ngastrat kadastrale në fjalë dhe ai nuk ka mundur as t'i humbte këto të drejta (të cilat nuk i ka gëzuar), si rezultat i ngjarjeve të vitit 1998/1999. Rrjedhimisht, kërkesat e parashtruesit nuk mund të kualifikohen si kërkesa që bien në kompetencën e institucionit të AKP-së.
59. Gjykata gjithashtu vëren se edhe Gjykata Supreme, në arsyetimet e të dy aktgjykimeve, sqaroi se aktgjykimet e saj *“nuk venë në pikëpyetje çfarëdo të drejte pronësore të pronarit të tashëm e as nuk paraqesin pengesë që palët të iniciojnë procedurë pranë organit kompetent ose gjykatës kompetente nëse këtë e konsiderojnë interes juridik”*.
60. Në bazë të lartcekurave, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës, në procedurën e iniciuar nga ana e tij në Gjykatën Supreme, ka ardhur deri te vendimi përfundimtar lidhur me fitimin e të drejtave të tij pronësore.
61. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i detyron ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion, pranë organeve tjera gjegjësisht gjykatave të rregullta, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
62. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të parandalojnë shkeljet kushtetuese apo të korrigjojnë ato përmes procedurave gjyqësore të rregullta, para se të vijë rasti për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendor ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, gjegjësisht të KEDNJ-së (shih, *inter alia*, Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI134/19 Dobrica Pucar, Aktvendim i 16 janarit 2020, shih *Aksoy kundër Turqisë*, paragrafi 51 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 18 dhjetorit 1996).
63. Në rastin konkret, Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës nuk i mori parasysh arsyetimet ligjore dhe udhëzimet juridike të dhëna nga AKP-ja dhe Gjykata Supreme në vendimet e tyre. Prandaj ai nuk ka filluar procedurën në institucionin kompetent, përkatësisht në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku do të shqyrtohej çështja e bazueshmërisë së “kërkesës” së tij në lidhje me pronën në fjalë. Në fakt, nga vendimet e kontestuar, si dhe në bazë të nenit 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është dashur së pari të paraqesë kërkesën pranë Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i cili, si i tillë, do të ishte kompetent për të vendosur mbi bazueshmërinë e kërkesës për kthimin e ngastrave lëndore në posedim.
64. Për më tepër, edhe nën supozimin se parashtruesi nuk është i kënaqur me Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më konkretisht të Autoritetit të

Likuidimit të kësaj Agjencie ai, në pajtim me nenin 4 - Juridiksioni të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka pasur mundësi për t'i vazhduar procedurat në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke paraqitur ankesën/padinë ndaj një vendimi të tillë.

65. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton se:

“Neni 4 Juridiksioni

1.Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim:

1.1 kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

[...]”

66. Prandaj, Gjykata, konstaton se parashtruesi i kërkesës e solli veten në një situatë procedurale ku kërkesëpadia e tij nuk mund të shqyrtohet në merita nga gjykatat e rregullta, për arsye se ai nuk ka vepruar në pajtim me kërkesat procedurale dhe detyrimet ligjore, të cilat mundësojnë fillimin e procedurës në gjykatat kompetente (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI134/19 *Dobrica Pucar*, të 16 janarit 2020).
67. Gjykata thekson se asgjë nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që të fillojë procedurën pranë autoriteteve dhe gjykatave kompetente në çdo kohë, me çka ai do të krijonte një mundësi procedurale që organet kompetente, gjegjësisht gjykatat e rregullta, të shqyrtojnë të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe të vendosin për të drejtat e tij pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës.
68. Për sa më sipër,, Gjykata arrin në përfundim se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të cilat i ka pasur në dispozicion, siç kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI134/19 *Dobrica Pucar*, Aktvendim i 16 janarit 2020, KI178/18, *Bujar Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 janarit 2019, paragrafi 26; si dhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI210/19, parashtrues *Sabri Ismaili*, të 15 korrikut 2020).
69. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi